 - Fuqizim i kapaciteteve në sistemin shëndetësor për të ndihmuar ata që duan t'a lënë duhanin. Trajnim dhe paisje me materiale ndihmëse e mjekëve dhe infermiereve të Shërbimit të Kujdesit Parësor (SHKP) fillimisht dhe më tej të Shërbimit Spitalor. Identifikimi dhe këshillimi i pacientëve lidhur me lënien e duhanit duhet të kryhet falas.

- Aktivitete në mbështetje të zbatimit të ligjit që parandalon duhanpirjen pasive në mjedise publike (fushata ndërgjegjësimi, masa administrative).
- Fushata publike për parandalimin e duhanpirjes sidomos në grupet që vlerësohen me rrezik në rritje si femrat dhe të rinjtë.
- Fushata në shkolla dhe në vendet e punës.
- Brenda politikave kombëtare të taksave duhen bërë përpjekje për rritjen e mëtejshme të aksizës për duhanin.
- Lajmërimet në paketat e duhanit duhet të bëhen më efektive.
- Heqja nga paketimi i brandit të duhanit (rasti i Australisë – rezultuar efektiv)
- Krijimi i një aplikacioni telefonik bazuar në kërkime shkencore për të lënë duhanin (ky mund të jetë një shërbim që mund të ofrohet nga ISHP apo në bashkëpunim me kompani private e subvencionuar nga shteti)
- ***Aktivitete të rekomanduara kundër ushqyerjes së pabalancuar dhe mbipeshës (që vlerësohet të jenë përgjegjëse për rreth 30%-35% të kancereve):***
 - Fuqizim i kapaciteteve në sistemin shëndetësor për depistimin dhe trajtimin e ushqyerjes jo të shëndetshme dhe mbipeshës. Trajnim dhe paisje me materiale ndihmëse e mjekëve dhe inferemiereve të SHKP. Identifikimi dhe këshillimi i pacientëve lidhur me ushqyerjen dhe mbipeshën duhet të kryhet falas.
 - Fushata ndërgjegjësimi në popullatën e përgjithshme me qëllim promovimin e marrjes së frutave dhe perimeve (të paktën 5 në ditë) dhe kontrollin e kalorive ditore. Fushata në shkolla dhe në vendet e punës.
 - Aktivitete avokatie me politikëbërës me qëllim futjen e kufizimeve mbi tregëtimin e ëmbëlsirave, ushqimeve me yndyrë të lartë, ushqimeve me shume kripë/konservantë dhe pijeve për fëmijët.
- ***Aktivitete të rekomanduara kundër jetës sedentare (që vlerësohet të jetë përgjegjëse deri në 5% të kancereve):***
 - Fuqizim i kapaciteteve në sistemin shëndetësor për depistimin dhe këshillimin mbi jetën sedentare. Trajnim dhe paisje me materiale ndihmëse e mjekëve dhe inferemiereve të SHKP. Identifikimi dhe këshillimi i pacientëve lidhur me aktivitetin fizik duhet të kryhet falas.
 - Fushata ndërgjegjësimi në popullatën e përgjithshme me qëllim promovimin e aktiviteteve fizike. Fushata në shkolla dhe në vendet e punës.
- ***Aktivitete të rekomanduara kundër konsumit të ekzagjeruar të alkoolit (që vlerësohet të jetë përgjegjës për rreth 3% të kancereve):***
 - Fuqizim i kapaciteteve në sistemin shëndetësor për depistimin dhe këshillimin mbi abuzimin me alkoolin. Trajnim dhe paisje me materiale ndihmëse e mjekëve dhe inferemiereve të SHKP. Identifikimi dhe këshillimi i pacientëve lidhur me abuzimin me alkoolin duhet të kryhet falas.

- Aktivitetet në mbështetje të ligjit që parandalon konsumin e alkoolit nga fëmijët dhe të rinjtë (fushata ndërgjegjësimi, masa administrative).
 - Fushata publike për parandalimin e abuzimit me alkool sidomos në të rinjtë. Fushata në shkolla dhe në vendet e punës.
 - Brenda politikave kombëtare të taksave duhen bërë përpjekje për rritjen e mëtejshme të aksizës për alkoolin.
- ***Aktivitete të rekomanduara kundra viruseve dhe agjentëve të tjerë biologjikë (që vlerësohet të jenë përgjegjës për 5%-10% të kancereve):***
 - Aktivitete brenda dhe jashtë programit kombëtar të vaksinimit me qëllim rritjen e mbulesës së popullatës së vaksinuar kundrejt virusit të hepatitit B dhe HPV.
 - Aktivitete promovuese mbi seksin e mbrojtur në popullatën e përgjithshme dhe në grupet me risk të veçantë, përfshirë të rinjtë.
 - ***Aktivitete të rekomanduara kundra rrezatimeve jonizuese dhe rrezatimit ultraviolet (që vlerësohet të jenë përgjegjës deri në 3% të kancereve):***
 - Fuqizim i kapaciteteve në sistemin shëndetësor për këshillimin mbi rreziqet e ekspozimit ndaj rrezatimit ultraviolet dhe praktikat e shëndetshme lidhur me qëndrimin në diell. Trajnim dhe paisje me materiale ndihmëse e mjekëve dhe infermiereve të SHKP.
 - Informim i publikut nëpërmjet fushatave sistematike mbi praktikat e shëndetshme lidhur me qëndrimin në diell, përfshirë një fokus i veçantë për gratë e reja.
 - Ndërgjegjësim i publikut dhe i autoriteteve përgjegjëse të standarteve të ndërtimit mbi rreziqet e radonit. Avokati për standarte të përshtatshme ndërtimi lidhur me mbrojtjen nga radoni.
 - Fushatë ndërgjegjësimi me fokus profesionistët e shëndetësisë mbi përdorimin e duhur të teknologjive diagnostikuese dhe trajtuese që emetojnë rrezatim.
 - Aktivitete inspektuese në mbështetje të zbatimit të ligjit mbi rrezatimet.
 - ***Aktivitete të rekomanduara kundër ndotjes mjedisore dhe faktorëve okupacionalë (që vlerësohet të jenë përgjegjës respektivisht për 2% dhe 5% të kancereve):***
 - Rishikim i standarteve, bazuar në eksperiencën e BE-së, lidhur me ekspozimin dhe monitorimin e lëndëve kancerogjene në vendet e punës.
 - Aktivitete në mbështetje të inspektimit lidhur me ndotjen e mjedisit nga gaze dhe grimca të rrezikshme.
 - Zgjerimi i sistemit të monitorimit të ndotjes së ajrit, me teknologjinë dhe mbulimin e përshtatshëm të territorit të vendit.
 - Përmirësim i sistemit të monitorimit lidhur me arsenikun në ujin e pijshëm.

3.4 Plani i zbatimit për Parandalimin Parësor të Kancerit

Objektiva	Aktivitete	Tregues të procesit	Koha	Institucione përgjegjës	Partnerë	Kosto
Fusha 1. Parandalimi primar						
Rritje e vazhdueshme aksizës së duhanit	Informim sistematik i Ministrisë së Financave mbi efektet në shëndet të aksizës së duhanit në kuadër të Komitetit ndërministerial të luftës kundër duhanit.	Numri i takimeve të kryera. Numri i raporteve të prodhuara mbi efektet që ka duhani në shëndet.	2022-2025	MSHMS	ISHP, MFE, Komiteti Ndërministror, ISHSH	
	Rritje e vazhdueshme e aksizës në përfrim me standartin e BE si dhe përmirësim i eficiencës së zbatimit të ligjit lidhur me kontrabandën në Shqipëri.	Përqindja e rritjes së aksizës. Numri i takimeve dhe monitorimeve për zbatimin e ligjit.	2022-2025	MSHMS	ISHP, MFE, Komiteti Ndërministror, ISHSH	
Përshkallëzimi i masave kundër duhanpirjes në mbështetje të Inspektoriatit Shëndetësor	Ndërtim i modeleve të monitorimit të hapësirave publike pa duhan dhe shitjes së duhanit dhe alkoolit tek adoleshentët. Në bashkëpunim me ISHP dhe OBSH dhe zbatim nga ana e pikave fokale të SJT në çdo rajon.	Numri i modeleve të krijuara për monitorimin e hapësirave publike. Numri i trajnimeve të pikave fokale të SJT-ve rajonale mbi këto modele. Numri i monitorimeve të kryera nga pikat fokale rajonale të SJT-ve.	2023-2025	ISHP	MSHMS, OBSH, OSHKSH/ NJVKSH ISHSH	
	Përgatitje e raporteve monitoruese çdo vit bazuar mbi verifikime sistematike të zbatimit të ligjit dhe organizim i takimeve me përfaqësues të inspektoratit për të identifikuar problemet.	Numri i raporteve vjetore të prodhuara. Numri i takimeve vjetore të realizuara.	2023-2025	ISHP	MSHMS, OBSH, OSHKSH/ NJVKSH ISHSH	

Përdorimi metodave inovative për të ndikuar në rrjetet e mediave sociale me modele të sjelljes së shëndetshme	Promovimi i modeleve të jetës së shëndetshme në rrjetet sociale (përfshi tik-tok, facebook, instagram) duke identifikuar dhe bashkëpunuar me persona me influencë tek të rinjtë dhe fëmijët (përfshi sportistë apo artistë të njohur).	Numri i modeleve të sjelljeve të shëndetshme të promovuara	2023-2025	MSHMS	ISHP, OSHKSH/ NJVKSH MASR	
Rritja e ndërgjegjësimit të publikut mbi kancerin dhe faktorët mjedisorë që ndikojnë në zhvillimin e kancerit	Shpërndarja e informacionit mbi parandalimin e kancerit tek publiku i gjerë, përfshirë faktorët kancerogjenë mjedisorë dhe profesionalë (në ambientet e punës)	Përqindja e popullatës së ndërgjegjesuar mbi parandalimin e kancerit (studim në popullatë). Numri i materialeve IEK të zhvilluara për parandalimin e kancerit.	2023-2025	ISHP	OSHKSH/ NJVKSH	
Mbeshtetja e aktoreve brenda dhe jashtë sistemit shëndetësor (OJQ, sektori privat, universitetet, bizneset) në aktivitete ndërgjegjësuese mbi parandalimin e kancerit	Mbeshtetje e iniciativave të ndermarrjeve publike dhe private për monitorimin e faktoreve risk për kanceret dhe diagnozën e hershme (përfshi mbështetje për depistimin e kancereve).	Numri i ndërmarrjeve dhe punonjësve të përfshirë në aktivitete	2022-2025	MSHMS	ISHP, OSHKSH/ NJVKSH, OJQ	
	Mbeshtetje e nismave të OJQ (përfshi të rinjtë) për parandalim të kancereve në komunitet.	Numri i nismave të mbështetura	2023-2025	MSHMS	ISHP, OSHKSH/ NJVKSH, OJQ	
	Bashkëpunim me universitetet lidhur me fushatën ndërgjegjesimi të studentëve për parandalimin e kancerit.	Numri i aktiviteteve të përbashkëta	2022-2025	ISHP	OSHKSH/ NJVKSH, UT	
Ndalimi i reklamimit të produkteve të mishit të përpunuar nga fëmijët	Ndërmarrja e një nisme ligjore bazuar në përvojën më të mirë ndërkombëtare	Numri i aktiviteteve të ndërmarrja për këtë nismë	2024-2030	MSHMS	ISHP dhe partnere	

Reduktimi i ushqyerjes së pa shëndetshme, mbipeshës	Fuqizim i kapaciteteve në sistemin shëndetësor për depistimin dhe trajtimin e ushqyerjes së gabuar dhe mbipeshës. Trajnim dhe paisje me materiale ndihmëse e mjekëve dhe infermiereve të kujdesin shëndetësor parësor. Identifikimi dhe këshillimi i pacientëve lidhur me ushqyerjen dhe mbipeshën.	Numri i trajnimeve të kryera. Numri i materialeve ndihmëse për kujdesin shëndetësor parësor. Përqindja e pacientëve të këshilluar dhe informuar për stilin e shëndetshëm të jetesës (nëpërmjet studimeve në popullatë).	2022-2025	MSHMS	ISHP, OSHKSH/ NJVKSH	
	Fushata ndërgjegjësimi në popullatën e përgjithshme me qëllim promovimin e marrjes së frutave dhe perimeve (të paktën 5 në ditë) dhe kontrollin e kalorive ditore. Fushata në shkolla dhe në vendet e punës.	Numri i fushatave ndërgjegjëse të kryera në popullatën e përgjithshme. Numri i fushatave ndërgjegjëse të kryera në shkolla dhe vendet e punës.	2023-2025	MSHMS	ISHP, OSHKSH/ NJVKSH MASR	
	Aktivitete advokatie me politikëbërës me qëllim futjen e kufizimeve mbi tregëtimin e ëmbëlsirave, ushqimeve me yndyrë të lartë, ushqimeve me shume kripë/konservantë dhe pijeve për fëmijët	Numri i aktiviteteve të kryera në nivel ndërsektorial.	2023	MSHMS	ISHP, QSUT dhe partnere	
Reduktimi i jetës sedentare në popullatën shqiptare	Fuqizim i kapaciteteve në sistemin shëndetësor për depistimin dhe këshillimin mbi jetën sedentare. Trajnim dhe paisje me materiale ndihmëse e mjekëve dhe infermiereve të kujdesit shëndetësor parësor. Identifikimi dhe këshillimi i pacientëve lidhur me aktivitetin fizik.	Numri i trajnimeve të kryera. Numri i materialeve ndihmëse dhe pajisjeve për kujdesin shëndetësor parësor. Përqindja e pacientëve të këshilluar dhe informuar për aktivitetin fizik (nëpërmjet studimeve në popullatë).	2023-2025	MSHMS	ISHP, OSHKSH/ NJVKSH	

	Fushata ndërgjegjësimi në popullatën e përgjithshme me qëllim promovimin e aktiviteteve fizike. Fushata në shkolla dhe në vendet e punës	Numri i fushatave ndërgjegjëse të kryera në popullatën e përgjithshme. Numri i fushatave ndërgjegjëse të kryera në shkolla dhe vendet e punës.	2022-2025	MSHMS	ISHP, OSHKSH/ NJVKSH	
Reduktim i konsumit të alkoolit në popullatën shqiptare	Fuqizim i kapaciteteve në sistemin shëndetësor për depistimin dhe këshillimin mbi abuzimin me alkoolin. Trajnim dhe pajisje me materiale ndihmëse e mjekëve dhe infermiereve të kujdesit shëndetësor parësor	Numri i trajnimeve të kryera. Numri i materialeve ndihmëse dhe pajisjeve për kujdesin shëndetësor parësor. Përqindja e pacientëve të këshilluar dhe informuar për abuzimin me alkoolin (nëpërmjet studimeve në popullatë).	2022-2025	MSHMS	ISHP, OSHKSH/ NJVKSH	
	Aktivitetet në mbështetje të ligjit që parandalon konsumin e alkoolit nga fëmijët dhe të rinjtë (fushata ndërgjegjësimi, masa administrative)	Numri i takimeve të kryera. Numri i fushatave ndërgjegjëse në shkolla dhe komunitet për fëmijët dhe të rinjtë. Numri i masave administrative të ndërmarra.	2022-2025	MSHMS	ISHP, OSHKSH/ NJVKSH	
	Fushata publike për parandalimin e abuzimit me alkool sidomos në të rinjtë. Fushata në shkolla dhe në vendet e punës.	Numri i fushatave publike të kryera. Numri i fushatave në shkolla dhe vendet e punës të kryera.	2022-2025	MSHMS	ISHP dhe partnere	
	Brenda politikave kombëtare të taksave duhen bërë përpjekje për rritjen e mëtejshme të aksizës për alkoolin	Numri i takimeve me aktorë ndërsektorialë për rritjen e aksizës mbi alkoolin.	2022	MSHMS	MFE dhe partnere	

Reduktim i incidencës së kancereve që shkaktohen nga agjentë infektivë	Aktivitetet brenda dhe jashtë programit kombëtar të vaksinimit me qëllim rritjen e mbulesës së popullatës së vaksinuar kundrejt virusit të hepatitit B	Numri i fushatave ndërgjegjësuese të kryera në popullatë. Numri trajnimeve dhe takimeve ndërgjegjësuese për profesionistët shëndetësorë dhe të tjerë.	2022-2025	MSHMS	ISHP, OSHKSH/ NJVKSH	
	Pilotimi i vaksinës HPV tek adoleshentët e grup moshës 11-12 bazuar në udhëzuesit me të mirë ndërkombetare	Pilotimi i vaksinimit HPV në 10,000 adoleshentë të grup moshës 11-12 vjeç	2022-2025	MSHMS	ISHP, OSHKSH/ NJVKSH	
	Aktivitetet promovuese mbi seksin e mbrojtur në popullatën e përgjithshme dhe në grupet me risk të veçantë, përfshirë të rinjtë	Numri i fushatave ndërgjegjësuese për seksin e mbrojtur në grupet me risk të lartë dhe të rinjtë. Numri i materialeve informuese të shpërndara.	2022-2025	MSHMS	ISHP, OSHKSH/ NJVKSH	
Reduktim i incidencës së kancereve të lëkurës si pasojë e ekspozimit të rrezatimit ultraviolet dhe jonizues	Fuqizim i kapaciteteve në sistemin shëndetësor për këshillimin mbi rreziqet e ekspozimit ndaj rrezatimit ultraviolet dhe praktikave të shëndetshme lidhur me qëndrimin në diell. Trajnim dhe pajisje me materiale ndihmëse e mjekëve dhe infermiereve të kujdesit shëndetësor parësor	Numri i trajnimeve të kryera. Numri i materialeve ndihmëse dhe pajisjeve për kujdesin shëndetësor parësor mbi praktikave të shëndetshme lidhur me ekspozimin në diell.	2023-2025	MSHMS	ISHP/ZMR Komiteti Rrezatimeve	
	Informim i publikut nëpërmjet fushatave sistematike mbi praktikave të shëndetshme lidhur me qëndrimin në diell, përfshirë një fokus i veçantë për gratë e reja.	Numri i fushatave informuese dhe ndërgjegjësuese i publikut mbi praktikave të shëndetshme lidhur me qëndrimin në diell, përfshirë për gratë e reja.	2023-2025	MSHMS	ISHP/ZMR dhe partnere	

	Ndërgjegjësim i publikut dhe i autoriteteve përgjegjëse të standarteve të ndërtimit mbi rreziqet e radonit. Avokati për standarte të përshtatshme ndërtimi lidhur me mbrojtjen nga radoni.	Numri i takimeve me autoritetet përgjegjëse mbi rreziqet e radonit. Numri i fushatave informuese dhe ndërgjegjëse në popullatë mbi rreziqet e radonit. Numri i takimeve advokuese me aktorët përgjegjës për krijimin e standarteve të përshtatshme ndërtimi lidhur me mbrojtjen nga radoni.	2023-2025	MSHMS	ISHP/ZMR, MIE dhe partnere	
	Fushatë ndërgjegjësimi me fokus profesionistët e shëndetësisë mbi përdorimin e duhur të teknologjive diagnostikuese dhe trajtuese që emetojnë rrezatim.	Numri i fushatave ndërgjegjëse të kryera me profesionistët shëndetësorë. Numri i trajnimeve të kryera me profesionistët shëndetësorë.	2023-2025	MSHMS	ISHP/ZMR dhe partnere	
	Aktivitete inspektuese në mbështetje të zbatimit të ligjit mbi rrezatimet.	Numri i inspektimeve të kryera.	2023-2025	MSHMS	ISHP, ISHSH dhe partnere	
Reduktim i ekspozimit ndaj ndotjes mjedisore dhe asaj në ambjentet e punës	Rishikim i standarteve, bazuar në eksperiencën e BE-së, lidhur me ekspozimin dhe monitorimin e lëndëve kancerogjene në vendet e punës.	Numri i takimeve për të rishikuar standartet e BE për ekspozimin dhe monitorimin e lëndëve kancerogjene në vendet e punës. Dokumenti i krijuar bazuar në standartet e BE për monitorimin e lëndëve kancerogjene në vendet e punës.	2023-2024	MSHMS	ISHP dhe partnere	

	Aktivitete në mbështetje të inspektimit lidhur me ndotjen e mjedisit nga gaze dhe grimca të rrezikshme	Numri i aktiviteteve ndërgjegjëse në popullatë ndotjen e mjedisit Numri i aktiviteteve ndërgjegjëse në mjediset e punës për ndotjet nga gaze dhe grimca të rrezikshme.	2024-2026	MSHMS	ISHP, MTM dhe partnere	
	Zgjerimi i sistemit të monitorimit të ndotjes së ajrit, me teknologjinë dhe mbulimin e përshtatshëm të territorit të vendit	Numri i aparaturave bashkohore të blera. Numri i rajoneve të pajisura me aparaturat bashkohore për monitorim. Numri i monitorimeve të kryera.	2024-2030	MSHMS	ISHP, MTM dhe partnere	
	Përmirësim i sistemit të monitorimit lidhur me arsenikun në ujin e pijshëm	Indikatorë limit të arsenikut në ujë të përcaktuar për monitorim bazuar në standartet e OBSH. Aparatura bashkëkohore për matjen e arsenikut në ujin e pijshëm. Numri i trajnimeve të stafit që kryen monitorimin e arsenikut në ujë bazuar në udhëzuesit e përditësuar.	2024-2028	MSHMS	ISHP dhe partnere	
Rritja e ndërgjegjësimit të mjekëve të familjes mbi parandalimin dhe diagnozën e hershme të kancerit	Dizenjimi i një programi trajnimi virtual për parandalimin dhe diagnozën e hershme të kancerit për profesionistët shëndetësorë në KSHP, si pjesë e programit të QKEV	Numri i profesionistëve të trajnuar	2022-2025	MSHMS	ISHP, QSUNT, QKEV dhe partnerë	

3.5 Plani i zbatimit për Depistimin dhe Diagnozën e Hershme të Kancereve

<i>Objektiva</i>	<i>Aktivitete</i>	<i>Tregues të procesit</i>	<i>Koha</i>	<i>Institucione përgjegjëse</i>	<i>Partnerë</i>	<i>Kosto</i>
Fusha 1. Depistimi						
Permiroimi i njohurive dhe aftësive të personelit në kujdesin parësor mbi programet e depistimit dhe minimizimi i risqeve për popullatën pjesëmarrëse	Perfshirja në kompetencat e pikave fokale për SJT pranë NJVKSH e ndjekjes së programeve të depistimit dhe të diagnozës së hershme.	Dokumenti i kompetencave për pikat fokale i përgatitur	2022	ISHP	OSHKSH rajonale dhe partnere	
	Perfshirja e njohurive dhe principeve të funksionimit të programeve të depistimit dhe diagnozës së hershme për kanceret në programin e një kursi trajnimi për pikat fokale.	Programi i përgatitur	2022	ISHP	OSHKSH rajonale dhe partnere	
	Organizimi i kursit të trajnimit dhe aktivitete të tjera të edukimit në vazhdim	40 persona të trajnuar	2022-2023	ISHP	OSHKSH Rajonale, donatore, OJQ	
	Përgatitja e një materiali mbi programet e depistimit dhe diagnozës së hershme të kancereve dhe organizimi i kurseve të edukimit në vazhdim mbi këto tema për gjithë profesionistët e kujdesit parësor të përfshirë në depistim	1000 mjeke apo infermiere të trajnuar	2024-2030	ISHP	OSHKSH Rajonale, donatore, OJQ	

Fuqizimi i programit të depistimit të popullatës për kancerin e qafës së mitrës. Rritje në vijimësi e mbulesës me depistim dhe sigurim i diagnozës dhe trajtimit të shpejtë të pre kancereve. (Target: 20000 gra të depistuar cdo vit)	Rritje në vijimësi e mbulesës me depistim për HPV pranë shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor përmes fushatave të komunikimit me popullatën target 40-50 vjeç	Te paktën 60% e popullatës target të depistuar për HPV (për një periudhë kohë 5 vjeçare për depistimin e radhës)	2022-2025	ISHP	MSHMS, QSUT, OKSH, QSH, Partnere	
	Zgjerim i grupmoshës target të përfshirë në programin e depistimit, nga 40-50 vjeç në 35-60 vjeç. Rritje e furnizimit me mjete konsumi për testim primar pranë qendrave shëndetësore	5000 kite testuese në vit shtesë	2022-2025	ISHP	MSHMS, QSUT, OKSH, QSH, Partnere	
	Forcimi i koordinimit në nivel lokal dhe qendror përmes organizimit të takimeve sistematike të institucioneve shëndetësore të përfshira (QSH, NJKVSH, Operatori, Spitalet Rajonale, ISHP, QSUT)	Personat fokale të përcaktuar në cdo rreth. 20 takime vjetore mes institucioneve të kryera	2022-2025	ISHP	MSHMS, QSUT, OKSH, QSH, Partnere	
	Sigurim i diagnozës dhe trajtimit të shpejtë dhe pa kosto për të gjitha gratë që rezultojnë pozitive në depistimin primar përmes komunikimit sistematik me personin focal në qendrën shëndetësore dhe grave pozitive	90% e grave pozitive për HPV kanë marrë shërbime të diagnozës dhe trajtimit për lëzionet premalinje	2022-2025	MSHMS	QSUT, ISHP, OShKSH, QSH, Partnere	
	Ngritja e një regjistri të	Regjistri i	2022-	ISHP	MSHMS, QSUT,	

	kolposkopise prane spitaleve universitare dhe spitaleve te pergjdhura rajonale per te siguruar ndjekjen ne vijimesi te grave pozitive dhe perllogaritur treguesit e programit	ngritur. 90% e kolposkopive te lidhura me depistimin te regjistruara	2023		OKSH, QSH, Partnere	
	Permiresimi i vazhdueshem i cilesise se testit depistues primar të HPV dhe diagnoses se prekancerit permes perllogaritjes sistematike te treguesve, shkembimit te informacionit dhe organizimit te takimeve periodike mes institucioneve.	4 tregues te programit te perllogaritur cdo vit	2023-2024	ISHP	MSHMS, QSUT, OKSH, QSH, Partnere	
	Kryerja e nje vleresimi te cilesise se programit me pjesemarrjen e perdoruesve dhe pergatitja e raporteve sistematike mbi programin bazuar mbi sistemin e informacionit rutine	1 studim i kryer Raporte cdo 2 vjet	2023	ISHP	MSHMS, QSUT, OKSH, QSH, Partnere	
	Ndertimi i nje plani kombetar afatgjate te parandalimit te kancerit te qafes se mitres ku te perfshihet edhe vaksinimi	Dokumenti i aprovuar	2022	MSHMS	QSUT, ISHP, OShKSH, QSH, Partnere	
	Akreditimi i qendrave te kolposkopise . Takime dhe workshop-e me ekspertë të fushave përkatëse për të krijuar standartet që duhet të përmbushin qendrat e tjera të kolposkopise në vendin tonë	Standartet dhe protokollet spitalore te miratuara. Qendrat te akredituara	2022-2023	Qendra e akreditimit dhe cilesise	QSUT. Spitale rajonale te perzgjedhura	
Zbatimi dhe fuqizimi i programit të	Aprovimi i kornizës teknike të programit të depistimit	Dokumenti i miratuar dhe i	2022	MSHMS	QSUT, ISHP, OShKSH,	

depistimit të popullatës për kancerin e gjirit. Rritje në vijimësi e mbulesës me depistim dhe sigurim i diagnozës dhe trajtimit të shpejtë të kancereve. (Target: 50000 gra të depistuar në vit)	dhe diagnozës së hershme dhe rregullimi i aksesit në shërbimet e reja për popullatën target	institucionet përgjegjëse janë njohur me të.			QSH, Partnere	
	Organizimi i fushatave të ndergjegjesimit lidhur me përdorimin e depistimit dhe diagnozës së hershme nga gratë e popullatës target dhe vijimin e kujdesit për gratë që referohen për diagnoze të metejshme	Te pakten 1 fushatë cdo vit. 30000-40000-50000 gra të depistuar në vit.	2022-2025-2030	MSHMS	ISHP, OKSH, OJQ, përdoruesit e shërbimeve, partnere	
	Mbeshtetje e vazhdueshme me kualifikim për radiologët përgjegjës për mamografine, dhe aplikimi i incentivave për rritjen e vazhdueshme të performancës. Ky trajnim përfshin mamografinë depistuese dhe diagnostikuese.	10 radiologë të rikualifikuar. Arrihet standarti i te pakten 100 mamografi për radiolog në javë.	2023-2025	MSHMS	QSUT, OKSH, partnere ndërkombëtare	
	<u>Percaktim i përgjegjësve</u> dhe kompetencave mbi depistimin në nivel NJKVSH dhe qendër shëndetësore dhe <u>ndjekje në vijimësi</u> e grave që rezultojnë pozitive në depistim.	90% e grave pozitive vijojnë të ndiqen nga specialisti (onkolog, senolog, kirurg gjiri, gjinekolog etj).	2022-2030	MSHMS	ISHP, OKSH, QSH, QSUT	
	Krijim i njesive koordinuese në nivel operatori rajonal	Te pakten 2 takime	2022-2030	MSHMS	ISHP, OKSH,	

	dhe shkëmbim i informacionit mes spitaleve, operatorit, ISHP dhe QSUT	periodike cdo vit ne nivel rrethi			QSH, QSUT	
	Krijimi i Qendres kombetare te references prane sherbimit onkologjik ne QSUT dhe aprovimi i kompetencave, pergjegjesive dhe sistemit vertikal te referimit. Gratë simptomatike duhet të kenë një rrugë të shpejtë për të përfunduar/konfirmuar diagnozën dhe për të filluar trajtimin.	Dokumenti i aprovuar nga Ministria dhe QSUT	2022-2023	MSHMS	QSUT	
	Rishikimi i protokolleve te trajtimit dhe ndjekjes afatgjate te kancerit te gjirit. Bazuar ne pervojen me te mire dhe ne kapacitetet reale	Udhëzimet dhe protokollet e duhura të miratuara	2022-2023	Qendra e akreditimit dhe cilesise	QSUT, Shoqata profesioni stesh, partnere	
	Ngritja e qendrave te reja te mamografise ne Tirane dhe dy qytete te tjera te medha te vendit	3 qendra te reja mamografise fikse te ngritura	2023-2030	MSHMS	OSHKSH	
	Ndertimi i nje sistemi te sigurimit te cilesise dhe permiresimit te vazhdueshem te saj, lidhur me qendrat e mamografise. Shkëmbim i informacionit mbi rezultatet imazherike, organizim i takimeve periodike te radiologeve dhe teknikeve te mamografise si dhe perfshirje e ekspertizes nderkombetare	1 konference kombetare vjetore cdo vit	2023-2030	QSUT	Spitale rajonale	
	Sigurim i mirembajtjes se vazhdueshme te teknologjise radiologjike	90% e njesive me sisteme te mirembajtjes se	2023-2030	MSHMS	OKSH, Spitale rajonale	

	permes aplikimit te procedurave standard dhe fondeve te dedikuara	miratuara dhe te financuara				
	Ndertimi i nje kursi te edukimit ne vazhdim per tekniket e mamografise	40 teknike te ri kualifikuar	2023-2025	QSUT, UMT	OSHKSH, QKEV	
	Pergatitja e raporteve periodike mbi treguesit e programit te depistimit	Raporte kombetare cdo dy vjet	2023-2030	ISHP	OSHKSH MSHMS QSUT Spitale rajonale	
	Hartimi i treguesve për monitorim dhe vlerësim	Treguesit e përgatitur.	2023-2025	ISHP	OSHKSH MSHMS QSUT Spitale rajonale	
	Kryerja e nje vleresimi te cilesise se programit me pjesemarrjen e perdoruesve.	1 studim i kryer.	2024	ISHP	OSHKSH MSHMS QSUT Spitale rajonale	
	Sigurimi i një game më të gjerë shërbimesh në sistemin e kujdesit shëndetësor me pajisje të përshtatshme për diagnozwn e hershme	Numri i spitaleve referuese rajonale ose të rretheve të pajisura siç duhet për diagnozen e hershme të kancerit të gjirit	2025-2030	MSHMS	OSHKSH	
	Mbeshtetje e vazhdueshme per grate me Kancer Gjiri	Te pakten 1 aktivitet ne vit me pjesemarrjen e shoqatave te grave me kancer gjiri	2022-2030	OSHKSH,ISHP	Europa Donna Psikologe, QSUT, partnere	
	Rishikimi i kurrikules se onkologjise per studentet	Programi i rishikuar dhe	2022-2024	UMT	QSUT, MSHMS	

	dhe specialistet e onkologjise me perfshirje te praktikave me te mira ne fushen e kontrollit te kancerit te gjirit	aprovuar ne Universitet				
Adaptimi i programit të depistimit të kancerit kolorektal, pjesë e kontrollit bazë shëndetësor. (Target: 100000 persona te depistuar cdo vit)	Rishikimi i kornizës teknike të programit dhe përcaktimi i një mekanizmi koordinues mes institucioneve (Operatori shendetesor, qendrat shendetesore, spitalet rajonale te perzgjedhura, QSUT dhe ISHP). Ai do të përfshijë rishikimin e popullatës së synuar për depistim (p.sh. njerëzit me rrezik të lartë për shkak të historisë familjare ose personale, dhe me sëmundje me rrezik të shtuar për të zhvilluar kancer) dhe prezantimin e një programi të diagnostikimit të hershëm për popullatën simptomatike	Dokumenti i pergatitur dhe i aprovuar	2022-2023	MSHMS	QSUT, ISHP, OSHKSH, QSH, Partnere	
	Kryerja e një vleresimi mbi përdorimin e shërbimeve të depistimit dhe ndjekjes së mëtejshme të personave që rezultojnë pozitivë	1 studim i kryer	2023-2024	ISHP	MSHMS, QSUT, OSHKSH, QSH, Partnere	
	Percaktimi i pergjegjesive ne nivel rajonal, rregullat e shkembimit te informacionit dhe ndjekja ne vijimesi e personave qe rezultojne positive ne testin primar.	90% e personave qe rezultojne pozitive ka kryer nje kolonoskopi	2022-2025	MSHMS	QSUT, ISHP, OShKSH, QSH, Partnere	
	Vleresimi i cilesise se testit primar dhe permiresimi i vazhdueshem i saj permes	Te pakten nje audit kombetar i kryer	2024	MSHMS	QSUT, ISHP, OShKSH, QSH,	

	organizmi te auditimit klinik ne te gjitha fazat e perfshira (nga qendrat shendetesore tek laboratori qendror i FOBT).				Partnere	
	Pergatitja e raporteve periodike mbi treguesit e programit te depistimit	Raport kombetar cdo dy vjet	2023-2030	ISHP	MSHMS, QSUT, OSHKSH, QSH, Partnere	
	Organizimi i nje rrjeti kombetar te specialisteve pergjegjes te kolonoskopise dhe perfshirja e eksperteve nderkombetare ne te. Trajnimi per kolonoskopine e depistimit mund te ketë nevojë për një trajnim më të thellë sesa kolonoskopia diagnostike Organizimi i konferencave periodike me fokus depistimin e kancerit kolorektal.	1 konference kombetare cdo vit	2024-2030	MSHMS	QSUT, ISHP, OShKSH, QSH, Partnere	
Pilotim i nje programi depistimi te kancerit te mushkërise	Depistimi i kancerit te mushkërise nepermjet tomografise se kompjuterizuar me rrezatim te ulet dhe vleresimi i grupeve me ne rrezik qe do te perfitojne nga ky depistim	Rreth 10,000 individ te depistuar	2025-2030	MSHMS	Sanatoriu m, ISHP, OShKSH, Partnere	
Permiresimi i njohurive dhe aftesive te personelit ne shendetin publik dhe kujdesin paresor mbi programet e depistimit dhe minimizimi i risqeve per popullaten	Perfshirja ne kompetencat e pikave fokale per SJT prane NJVKSH e ndjekjes se programeve te depistimit dhe te diagnozes se hereshme.	Dokumenti i kompetencave per pikat fokale i pergatitur	2022	ISHP	OSHKSH, MSHMS, NJVKSH	

pjesemarrese.						
	Perfshirja e njohurive dhe principeve te funksionimit te programeve te depistimit dhe diagnozes se hershme per kanceret ne programin e nje kursi trajnimi per pikat fokale	Programi i pergatitur dhe miratuar	2022	ISHP	OSHKSH, MSHMS, NJVKSH	
	Organizimi i kursit te trajnimit dhe aktivite te tjera te edukimit ne vazhdim	40 specialiste te shendetit publik te trajnuar	2022-2023	ISHP	OSHKSH, MSHMS, NJVKSH	
	Pergatitja e nje materiali mbi programet e depistimit dhe diagnozes se hershme te kancereve dhe organizimi i kurseve te edukimit ne vazhdim mbi kete teme per gjithë profesionistet e kujdesit paresor te perfshire ne depistimi	1000 mjeke apo infemiere te trajnuar	2023	ISHP	OSHKSH, MSHMS, NJVKSH	
Heqja e gjithë barrierave financiare per depistimin	Propozimi i nje ligji mbi zbulimin e hershem	Dokumenti i miratuar nga MSHMS	2022-2023	MSHMS	FSDKSH, ISHP, OSHKSH	
Aplikimi i modeleve te vleresimit mbidiagnozes, mbitrajtimit sipas niveleve te riskut	Pergatitja e nje modeli te monitorimit te mbidiagnozes dhe mbitrajtimit nga depistimi. Per permiresimin e vazhdueshem te kostoeftektivitetit dhe minimizimin e demeve	Dokumenti i miratuar	2023	FSDKSH	MSHMS, ISHP, OSHKSH, QSUT, Partnere	

4. DIAGNOZA DHE TRAJTIMI I KANCEREVE

4.1 Analizë e situatës

Zbulimi dhe trajtimi i hershëm janë një domosdoshmëri për arritjen e objektivave që synojnë të ulin vdekshmërinë nga kanceri. Të dy këto komponentë janë strategjia më e mirë për t'i dhënë shans të sëmurëve me kancer për t'u diagnostikuar dhe trajtuar sa më herët, për t'u shëruar plotësisht, për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe mbi të gjitha për të rritur jetëgjatësinë.

Përmirësimi i shërbimeve të diagnostikimit dhe të trajtimit, të bazuar në protokolle dhe udhëzues shkencorë janë thelbësore për diagnostikimin dhe zbulimin efektiv të kancerit, mundësisht në stadin e hershëm të zhvillimit të tij, si dhe në përcaktimin e stadi të kancerit dhe trajtimin e duhur të tij (përfshirë kirurgjinë, trajtimin sistematik dhe radioterapinë). Në një diagnostikim dhe trajtim të hershëm dhe të suksesshëm, përfshihen si prezantimi i metodave dhe teknologjisë së duhur, ashtu edhe trajnimi i duhur dhe i vazhdueshëm i specialistëve (mjekë, infermierë, teknikë laborator, etj.) për të përdorur teknologjinë në shërbim të pacientit si në drejtim të diagnozës ashtu edhe të trajtimit. Pacientët diagnostikohen dhe trajtohen nga një ekip multi-disiplinor me specialistë të fushave specifike të trajnuar, përfshirë edhe ata të kujdesit paliativ, pra kujdesi për pacientin me kancer është një shërbim multi-disiplinor dhe gjithëpërfshirës. Tashmë në vendin tonë është arritur një formim i mirë universitar dhe trajnime për njohuri lidhur praktikat më të mira ndërkombëtare për stafin shëndetësor, veçanërisht për mjekët onkologë dhe mjekët e familjes. Është krijuar lista esenciale e barnave onkologjike, e cila zbatohet rregullisht e bazuar në protokolle, si dhe rishikohet e përmirësohet në vazhdimësi.

Aktualisht në vendin tonë, burimet në dispozicion për luftën kundër kancerit përfshijnë sa më poshtë vijon:

- Shërbimi Kombëtar i Onkologjisë në Spitalin Universitar “Nënë Tereza” si i vetmi institucion publik i specializuar në vend, me një ekip multi-disiplinor i cili merret me diagnozën dhe trajtimin e kancerit.
- *Spitalet rajonale*: përgjithësisht nuk janë të pajisura në mënyrë bashkëkohore dhe kanë profesionistë shëndetësor më pak të kualifikuar për diagnostikimin dhe trajtimin e kancerit.
- *Qendrat Shëndetësore të Kujdesit Shëndetësor Parësor dhe Poliklinikat e Specialiteteve*: në të gjithë vendin qendrat shëndetësore ofrojnë parandalim parësor (informim dhe edukim), depistim për kancerin e gjirit, të qafës së mitrës dhe atij kolorektal, referojnë pacientët për diagnozë tek shërbimet spitalore të specializuara, gjithashtu në rrethet me kryesore të vendit, qendrat shëndetësore ofrojnë dhe shërbime paliative. Mjeku i familjes është një pikë kontakti kyç për pacientët dhe shërben si urë lidhëse mes pacientëve me kancer dhe sistemeve të specializuara të diagnostikimit, trajtimit dhe kujdesit paliativ.
- *Shërbimet private*: ekziston vetëm një qendër spitalore komplekse private në Tiranë, Spitali Hygeia, i cili ofron me cilësi të lartë një shërbim kompleks multi-disiplinor në onkologji përfshirë edhe radioterapinë me 2 akseleratorë linear, por ku çdo gjë bëhet kundërt pagesave të drejtpërdrejta nga ana e pacientëve. Spitali Amerikan ofron gjithashtu një shërbim modern

diagnostik si dhe mjekim me kirurgji e kimioterapi, gjithashtu kundrejt pagesave të drejtpërdrejta nga ana e pacientëve.

- Medikamentet (barna, kimioterapia etj.) zënë një peshë të rëndësishme në trajtimin e kancerit. Përdorimi i medikamenteve bëhet në zbatim të protokolleve bazuar mbi evidencë, mbështetur në politikat e qarta për përdorimin e këtyre medikamenteve, duke zgjedhur ato më kosto-efektivitet dhe duke i dhënë përparësi medikamenteve kurative të provuara pa përjashtuar ato inovative. Kostoja e këtyre medikamenteve është një nga kostot më të mëdha të sistemeve shëndetësore në botë gjithashtu edhe në vendin tonë.
 - Prioriteti i politikës mjekësore në këtë fushë është sigurimi i barnave esenciale të miratuara për trajtimin e të gjitha llojeve të kancereve të kurueshme si dhe të kujdesit paliativ.
 - Njëkohësisht do të vlerësohen barnat inovative për të siguruar aksesin e pacientëve në përdorimin e tyre kur është e indikuar.
- Në spitalin onkologjik janë futur teknika të reja të kirurgjisë rikonstruktive onkoplastike të gjirit së bashku me limfonodulin sentinel, por që ka nevojë për mbështetje të mëtijshme për realizimin në vazhdueshmëri të këtyre teknikave.
- Gjithashtu do të shtohet në gamen e trajtimeve radioterapeutike edhe radioterapia stereotaktike e trupit. Aktualisht ofrohet radiokirurgjia e lezioneve intrakraniale dhe shtrirja e këtij trajtimi në lokalizimet ekstrakraniale është e mundur për shkak të eksperiencës tashmë të përfituar.
- Rritja e kapaciteteve diagnostikuese e trajtuese nën ndikimin e protokolleve të unifikuara sipas standarteve të miratuara nga shoqata e Onkologjisë dhe Hematologjisë Europiane dhe Amerikane, ngritja dhe forcimi i Qendrës së Referencës Kombëtare (QRK) në QSUT mund të sjellë në mënyrë direkte dhe mbylljen e ciklit të trajtimit brenda vendit.
- Në saj të investimeve të kryera në 5 vitet e fundit në Shqipëri dhe ato në vazhdim do të mbyllet cikli i diagnostikimit të të gjitha llojeve të kancereve.
- Në sajë të zhvillimit të infrastrukturës dhe ngritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore është e mundur shtrirja horizontale në vend e disa shërbimeve veçanërisht në diagnozë dhe trajtimin e sëmundjeve onkohematologjike duke bërë të mundur kujdesin për pacientin pranë vendbanimit.

Njësia e Radioterapisë është qendër unike e shërbimit spitalor publik në vend e cila trajton rreth 90% të pacientëve që marrin këtë lloj trajtimi në QSUT e cila gjatë dekadës së fundit ka pësuar një ndryshim të jashtëzakonshëm duke shënuar kalimin nga era e Kobaltit dhe teknikave 2D dhe 3D në erën e Akseleratorëve Linearë, paisje bashkohore të rrezatimit që përdoren në pjesën më të madhe të klinikave në vendet e zhvilluara.

Ndryshimi i arritur me investimet e kryera në infrastrukturë, makineri dhe trajnimin e burimeve njerëzore në Njësinë e Radioterapisë në Shqipëri e kualifikoi dhe promovoi qendrën e njesisë së radioterapisë si histori suksesi e bashkëpunimit të ANEA_s me qeverinë Shqiptare në vitin 2018.

Teknikat e avancuara që aplikohen nëpërmjet këtyre pajisjeve mundësojnë trajtimin e një game të gjerë tumoresh të pa trajtueshme me teknikat e mëparshme. Gjithashtu, në mënyrë të veçantë nga këto teknika përfitojnë grupe vulnerabël si moshat pediatrike apo geriatrike. Investimet në pajisje dhe sofëare i kanë mundësuar kësaj qendre aplikimin e inovacioneve të trajtimit kryesisht në patologji të kokë-qafës, gjirit, prostatës, të tumoreve solide të moshave pediatrike, etj.

Arritje tjetër e rëndësishme e shënuar si impakt i investimeve në këtë fushë është rritja e kapacitetit trajtues nga 900 në 1350 pacientë në vit me një ngarkesë mesatare prej 100-120 pacientë në muaj të cilët marrin trajtim që varion nga 1-10 seanca për rastet paliative, në 25-39 seanca për rastet kurative.

Krahas rrezatimit të jashtëm që përbën pjesën më të madhe të trajtimeve, Njësia e RT trajton rreth 400 pacientë me tumore sipërfaqësore të lëkurës dhe buzës nëpërmjet pajisjes së Ortovoltazhit.

Radioterapia është një nga metodat kryesore të përdorura për trajtimin e patologjive tumorale. Sot në vendet e zhvilluara nga kjo metodë trajtimi përfitojnë 50-60% e totalit të pacientëve me kancer të paktën një herë përgjatë sëmundjes (29-32). Roli i kësaj metode në trajtimin e kancerit është i shumëfishtë: i) Si trajtim parësor apo definitiv ku pacienti trajtohet vetëm me RT; ii) Neo adjuvant (Para Kirurgjisë) iii) Adjuvant, Post operator (vetëm apo e kombinuar me KT) si dhe iv) Radioterapia paliative për të lehtësuar morbiditetin e sëmundjes në fazat e saj të avancuara.

Si e tillë Radioterapia përdoret (qoftë vetëm ose në kombinim me kimioterapi, hormon ose imunoterapi), në trajtimin e tumoreve të lokalizuara dhe lokalisht të avancuar, për të parandaluar përsëritjen e sëmundjes pas trajtimit radikal kirurgjik, për zvogëlimin potencial të tumoreve kryesore, d.m.th. shndërrimin e inoperabilitetit fillestar në operabël. Roli i Radioterapisë mbetet i rëndësishëm gjithashtu për pacientët në stadi të avancuara (metastatike) për lehtësimin e dhimbjes, kompresionit dhe hemoragjisë) kur tumori është i pashërueshëm (31-34).

Investimi në modernizimin e Njesisë së Radioterapisë ka kthyer atë në një qendër moderne që ofron mundësi trajtimi të njëjta me qendra të ngjashme të vendeve të Evropës duke shënuar një përmirësim cilësor historik me kalimin e trajtimit të jashtëm me RT nga epoka e Kobaltit në atë të Akseleratorit Linear.

Një vlerësim i përgjithshëm i kryer me mbështetjen e IAEA_s në vitin 2021 mbi protokollet e trajtimit me radioterapi thekson nevojën për rishikimin e protokolleve të diagnostikimit, adresimit dhe trajtimit të pacientëve të sëmurë me kancer. Shërbimi parësor shëndetësor si niveli më i afërt i aksesit ka një rol kyç jo vetëm në diagnostikimin e hershëm por dhe në ndërgjegjësimin mbi përfitimet nga modalitetet e trajtimit përfshirë atë me Radioterapi ku avancimet teknologjike kanë mundësuar një reduktim të jashtëzakoshëm të risqeve dhe efekteve anësore.

Agjensia Ndërkombëtare Energjisë Atomike në bashkëpunim me Qeverinë Shqiptare ka luajtur një rol kyç në krijimin e kapaciteteve teknologjike dhe njerëzore për të bërë të mundur ofrimin e këtij modaliteti trajtimi për të sëmurët me kancer në vendin tonë. Roli i ANEA_s do të vazhdojë të mbetet i rëndësishëm në këshillimin mbi vijimësinë e forcimit të kapaciteteve dhe garantimin e sigurisë dhe cilësisë së trajtimit me Radioterapi në vendin tonë.

Deklarata e re e vizionit të (ESTRO) « Shoqatës Evropiane të Radioterapisë Onkologjike » për vitin 2030 **‘Radioterapia Onkologjike : Shëndet Optimal për të Gjithë, Së bashku’** thekson ambicien për të përforcuar më tej Radioterapinë Onkologjike si partner kyç në kujdesin multidisiplinar të kancerit dhe për të garantuar Radioterapi të aksesueshme dhe me vlerë të madhe për të gjithë pacientët me kancer që kanë nevojë për të.

Shoqata thekson si rrugë për të realizuar këtë vizion përqëndrimin në mënyrë aktive në përkthimin e shkencës dhe evidencave në praktikë. Mbështetjen e të gjithë profesionistëve të radioterapisë në nevojat e tyre të zhvillimit të vazhdueshëm profesional. Adresimin në mënyrë aktive të nevojave të një shoqërie në rritje në drejtim të qeverisjes dhe lidershit. Shoqata Evropiane synon të përqafojë gjithnjë e më shumë rolin e saj në politikë, përmes një rrjeti të zgjeruar partneriteti me të gjithë aktorët e përfshirë.

Agjensia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike (IAEA) sugjeron se një parashikim në lidhje me të ardhmen e radioterapisë duhet të bazohet në një vëzhgim të kujdesshëm dhe analiza të tendencave aktuale. Në terma të përgjithshëm, zhvillimet e ardhshme në Radioterapinë onkologjike lidhen me dy kategori të gjera: zhvillimet në teknologji që do të përmirësojnë saktësinë e dhënies së dozës fizike dhe zhvillimet në biologji që do të rrisin selektivitetin e vrasjes së qelizave nga rrezatimi, duke u përmirësuar kështu indeksi terapeutik. Për planifikuesit e shëndetit, organizatat ndërkombëtare ose organizatat joqeveritare (OJQ) të angazhuara në bashkëpunim teknik për të forcuar shërbimet e Radioterapisë në të gjithë botën, është e rëndësishme që të skanojnë horizontin shkencor dhe të identifikojnë zhvillimet dhe tendencat që mund të ndikojnë në Radioterapinë onkologjike në të ardhmen dhe të jenë gati për to.

Praktika e Klinikave Publike të Republikës Turke, një vend me një sërë karakteristikash shoqërore e kuturore të ngjashme me kontekstin tonë, ku ndërgjegjësimi i popullatës për kujdesin ndaj shëndetit është i alteruar, aplikojnë një qasje të organizimit dhe funksionimit me fokus tek nevoja e pacientit të karakterizuar nga një operacionalitet në ndërveprimin me strukturat e tjera të përfshira në procesin e trajtimit si departamentet e Kirurgjisë, Radiologjisë, Anatomopatologjisë, etj. duke siguruar një veprim imediat trajtimi veçanërisht për tumoret më agresive dhe stadet e avancuara duke rritur kështu në mënyrë të jashtëzakonshme efektivitetin e trajtimit dhe mundësinë e mbijetesës.

Mbështetur në objektivat e programit kombëtar të kancerit dhe në metodologjinë bashkëkohore të diagnostikimit dhe trajtimit do të arrihet:

- Sigurimi i disponueshmërisë dhe qasjes në shërbimet efektive të diagnostikimit dhe trajtimit.
- Përmirësimi i teknologjisë për patologjinë (anatominë dhe patologjinë, investimet në biologjinë molekulare, dhe imunohistiokiminë), diagnostikën imazherike dhe laboratorike, si dhe radioterapinë.

- Forcimi i cilësisë së diagnozës përmes integritit të gjithë procedurave ekzaminuese, nga depistimi deri tek testet e bio-markersave me synim përsheptimin e afateve të ndërhyrjes dhe orientimin e ndërhyrjeve më të përshtatshme trajtuese (si psh. lloji i kirurgjisë, trajtimi afatgjatë me kimioterapi).
- Promovimi i standardeve kombëtare minimale thelbësore për stadifikimin dhe trajtimin e kancerit të gjirit dhe melanomës.
- Krijimi i udhërrëfysve për shërbimet e trajtimit, listën e barnave thelbësore dhe trajnimin/edukimin e vazhduar.
- Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore në fushën e kancerit të gjirit dhe melanomës.
- Standartizimi i terapisë nëpërmjet përshtatjes dhe përhapjes së protokolleve të zgjedhura [për diagnozë dhe trajtim (kirurgji dhe terapi)] për kanceret më të shpeshta dhe më të trajtueshme në vend.
- Hartimi i një politike të qartë medikamentoze kosto-efektive dhe sigurimi i barnave të zgjedhur për të gjithë pacientët dhe gjatë gjithë vitit në mënyrë të qëndrueshme.
- Vendosja e metodave të qarta të referimit, pikave fokale dhe triazhimi i mundshëm i pacienteve me kancer.
- Hartimi i indikatorëve dhe sistemeve për matjen e impaktit të kujdesit të përmirësuar ndaj kancerit (indikatorë të monitorim vlerësimit).
- Rritja e investimeve në trajtimin e sëmundjes, investimeve në medikamente dhe teknologji.
- Përfundimi i shërbimit të ri të hematologjisë sipas standartit të kërkuar dhe parashikimi i investimeve për trajtimin me terapi qelizore të të sëmurëve me hemopatimalinje dhe jo vetëm.
- Rritja e kapaciteteve trajtuese do të çojë në modifikimin e kurrikulës së shkollës së specializimit në hematologji dhe të shkollës së doktoraturës duke rritur kërkimin shkencor në vend.
- Për të sëmurët e diagnostikuar të hiqet referenca e mjekut të familjes dhe mjekut specialist.
- Të shtohet në gamën e trajtimeve radioterapeutike edhe radioterapia stereotaktike e trupit. Aktualisht ofrohet radiokirurgjia e lezioneve intrakraniale dhe shtrirja e këtij trajtimi në lokalizimet ekstrakraniale është e mundur për shkak të eksperiencës tashmë të përfutur.
- Krijimi i Qendrës së Referencës Kombëtare të Kancerit në Shqipëri.
 - Të funksionojnë mbledhjet multidisiplinare si grupet që marrin vendimet e trajtimit të sëmurit me kancer.
 - Në qendrën e ekselencës/referencës por edhe në çdo shërbim ku ofrohet kujdes për të sëmurët me sëmundje malinje, vendimi për çdo hap terapeutik duhet të merret në këtë mbledhje multidisiplinare.

4.2 Krijimi i Qendrës së Referencës së Kancerit në Shqipëri (QRK)

Misioni: QRK shërben si një qendër reference për shërbimet onkologjike multidisiplinare, për diagnostikimin, trajtimin dhe kurimin e kancerit duke u fokusuar drejt qasjeve të personalizuar. Gjithashtu QRK drejton, zhvillon dhe mbështet kërkimin shkencor mbi kancerin në të gjithë vendin për të avancuar njohuritë shkencore dhe për të ndihmuar që të gjithë njerëzit të jetojnë jetë më të gjatë dhe të

shëndetshme (35-37). Qendra gjithashtu merret me mbledhjen, ruajtjen dhe anonimizimin e të dhënave të pacientëve të diagnostikuar me kancer, që më pas do përdoren për kërkime shkencore.

Në mënyrë të veçantë, QRK fokusohet në disa role të gjera (35-37):

1. Ofron kujdes shëndetësor të përqendruar tek pacienti, që nga diagnostikimi dhe trajtimi deri tek kujdesi paliativ dhe mbijetesë
2. Përmirësim, trajnim dhe mbikqyrje për qendrat/shërbimet rajonale të ofrimit të kujdesit ndaj kancerit në të gjithë vendin.
 - Krijimi i modeleve të ofrimit të kujdesit ndaj kancerit në nivel rajonal
 - Monitorimi & vlerësimi si dhe çertifikim i qendrave/shërbimeve rajonale të ofrimit të kujdesit ndaj kancerit
3. Hulumtim/kërkim shkencor në fushën e kancerit.
 - Drejton dhe udhëheq përpjekjet kërkimore për të përmirësuar parandalimin, zbulimin, diagnostikimin, trajtimin dhe mbijetesën nga kanceri
 - Koordinon dhe mbështet të gjitha proceset lidhur me diagnostikimin dhe trajtimin në mbarë vendin
 - Mbështet kërkimin shkencor në të gjithë shërbimet e ofruara
 - Kërkon dhe nxit krijimin e partneriteteve me industrinë, organizatat ndërkombëtare, agjencitë dhe institucionet e tjera kombëtare dhe të huaja për t'u angazhuar në mundësitë e kërkimit dhe trajnimit të kancerit që përndryshe nuk do të ishin të mundshme për shkak të kompleksitetit dhe kostos së tyre
4. Trajnim dhe Mbështetje për studiuesit / ofruesit e shërbimeve të kancerit
 - Përpiqet të tërheqë, trajnojë dhe mbajë stafin ekselent për t'u bërë gjenerata e ardhshme e studiuesve të kancerit
 - Ofron programe trajnimi/specializimi gjithëpërfshirëse që mbështesin nevojat e individëve të kualifikuar në të gjitha fazat e zhvillimit të karrierës së tyre, duke filluar nga studentët, specialistët dhe deri tek studiuesit e pavarur
5. Hartim i udhëzuesve dhe protolleve të diagnostimit, trajtimit, ndjekjes afatgjatë dhe kujdesit paliativ për lloje të ndryshme kanceresh
6. Ofron mbledhjen e të dhënave të pacientëve të diagnostikuar me kancer, të cilat më vonë përdoren për studime epidemiologjike apo dhe kërkime shkencore me të detajuara.
7. Promovim i parandalimit, edukimit dhe ndërgjegjësimin në fushën e kancerit

4.3 Plani i zbatimit për Diagnozën dhe Trajtimin e Kancereve

<i>Objektiva</i>	<i>Aktivitete</i>	<i>Tregues te procesit</i>	<i>Koha</i>	<i>Institucione pergjegjes</i>	<i>Partnere</i>	<i>Kosto</i>
Fusha 1. Diagnoza dhe trajtimi						
1. Përmirësimi i aksesit dhe cilësisë së shërbimeve diagnostikuese dhe trajtuese të kancerit	1.1 Hartimi dhe zbatimi protokolleve dhe standarteve klinike për diagnostikimin dhe trajtimin e kancereve	Protokollet të zhvilluara dhe miratuara me nivelet përkatëse të aplikimit	2022-2025	QSUT	MSHMS, Fakulteti i Mjekësisë, Agjensitë Ndërkombëtare	
	1.2 Hartimi dhe zbatimi protokolleve dhe standarteve klinike për diagnostikimin dhe trajtimin e kancereve me te shpeshte (duke perfshire kancerin e gjirit, melanomen etj.)	Protokollet të zhvilluara dhe miratuara me nivelet përkatëse të aplikimit	2022-2025	QSUT,	MSHMS, Fakulteti i Mjekësisë, Agjensitë Ndërkombëtare	
	1.3 Hartimi dhe zbatimi protokolleve dhe vijave/rrugeve te kujdesit ne menyre gjithëpërfshirëse (ICHOM/ NCCN/NICE) për diagnostikimin dhe trajtimin e te gjithë kancereve.		2022-2025			
	1.4 Zhvillimi i mekanizmave të sigurimit të cilësisë për të mbikëqyrur menaxhimin e duhur për pacientët me kancer dhe respektimin e etikës	Skemat e sigurimit të cilësisë, politikat e trajtimit dhe paraqitjet etike janë vendosur	2023-2025	QKCSAISH	MSHMS, QSUT, partnere	
	1.5 Sigurimi i cilësisë së pajisjeve laboratorike dhe e trajtimit, infrastrukturës dhe materialeve (përfshirë medikamentet) për trajtimin e kancerit të jenë të standardeve të larta.	Pajisjet cilësore, infrastruktura dhe materialet janë të ofruara në nivelet përkatëse të ofrimit të shërbimeve	2025-2030	MSHMS	QSUT, Fakulteti i Mjekësisë, Agjensitë Ndërkombëtare,	
	1.6 Përfshirja ne gamen e trajtimeve radioterapeutike edhe radioterapia stereotaktike e trupit. Aktualisht ofrohet radiokirurgjia e lezioneve	Radioterapia stereotaktike e trupit e vendosur.	2026	QSUT	MSHMS, Fakulteti i Mjekësisë, Agjensitë Ndërkombëtare,	

